

**AKT- THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“ERLIN KEMBIM” SH.P.K.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **“ERLIN KEMBIM” Sh.p.k.**

1- **Kiara Meçe**, shtetas Shqiptar, lindur me 07/05/1992 ne Librazhd, identifikohet nepermjet kartes se identitetit Nr. 028946112;

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë **“ERLIN KEMBIM” Sh.p.k.** mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1  
FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise eshte **“ERLIN KEMBIM” Sh.p.k.,.**

**NENI 2  
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

**NENI 3  
SELIA**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga “Muhamed Gjollështa” Pallat 6-katesh, kati 1, midis Raiffeisen Bank dhe Credins Bank, Tirane, Shqiperi.

Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

**NENI 4  
KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE**

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria priset dhe kalon në procedure likuidimi, sipas rasteve te parashikuara me ligj.

## **NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Shoqëria “**ERLIN KEMBIM**” Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqërie të konsulences dhe sherbimeve ndaj shoqerive ne Republikën e Shqipërise dhe ne territoret e tjera dhe ka si objekt të veprimitarise së saj:

### **5.1 Zhvillimin e aktivitetit te kembimit valutore .**

Me qëllim arritjen e objektit të saj, shoqëria me vendim të organit kompetent, mund të zotëroje në mënyre të drejtpërdrejte apo të tërthortë pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, të aktiviteve te ndryshme. Pjesmarrja në shoqëri që për llojin e tyre nuk ofrojne përgjegjësi të kufizuar, miratohet paraprakisht nga asambleja e ortakeve.

## **NENI 6 KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i shoqërise është 1.500.000 Leke (njëmilione pesëqinmije), i ndare në 1 pjese. Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

<b>1- Kiara Meçe</b>	<b>100,00 %</b>
----------------------	-----------------

Kapitali themeltar i shoqërise është shlyer tërësisht dhe depozituar ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

## **NENI 7 AKTET E SHOQERISE**

Shoqeria do te rregullohet, pervec këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërise.

## **NENI 8 ORGANET DREJTUESE**

Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret

2



për të përcaktuar administratorët e shoqërise "ERLIN KEMBIM" Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezigjatja dhe kompetencat e tyre. Administrator të shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjeçare është emëruar : **Kiara Meçe** .

## NENI 9 DISPOZITAT E FUNDIT

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.

Ky akt themelim është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën shqipe, duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

**Tirane, 09/02/2017**

### ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE "ERLIN KEMBIM" SH.P.K.

**Kiara Meçe**

 3